



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 711 Akti

Nr. 729 Vendim
Tiranë, më 10.1.2024

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 2 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare znj. Marie Tuma, në datën 13.12.2023, ora 13:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Zena Lila**, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Zena Lila është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2.

2. Me vendimin e trupit gjykues datë 15.1.2021 është vendosur kryesues komisioner Olsi Komici dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Më tej, subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
4. Janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP). Subjekti është kontaktuar nëpërmjet adresës elektronike, të deklaruar për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua pyetëtori i përgatitur nga Komisioni, si dhe pyetje të tjera gjatë hetimit administrativ.
5. Në datën 8.11.2023, trupi gjykues vendosi: (a) të përfundojë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Zena Lila, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale; (b) ta njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe barrën e provës, ta ftojë atë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (c) ta njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
6. Subjekti u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin edhe e konfirmoi. Subjekti i rivlerësimit, në datën 20.11.2023, ka kërkuar shtyrjen e afatit për dorëzimin e dokumentacionit në funksion të barrës së provës, me arsyetimin se ka qenë në pamundësi të të pasurit të kohës së nevojshme për përgatitjen e një mbrojtjeje efektive. Komisioni ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit, duke konsideruar edhe faktin që ka pasur probleme shëndetësore në vazhdimësi dhe e ka shtyrë afatin për dorëzimin e dokumentacionit deri në datën 7.12.2023.
7. Subjekti paraqiti brenda afatit të caktuar shpjegime dhe prova lidhur me barrën e provës dhe rezultatet e hetimit të Komisionit.
8. Trupi gjykues në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, ftoi subjektin e rivlerësimit Zena Lila për t'u paraqitur në seancë dëgjimore në datën 13.12.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve.
9. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 13.12.2023, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit personalisht në këtë seancë, por u përfaqësua nga avokati i saj F. L., me nr. licence ***, në sajë të Prokurës së Posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.12.2023, hartuar nga noter K. Q. K..
10. Gjatë kësaj seance përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit parashtrroi qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe kërkoi marrjen nga ana e Komisionit të disa provave shtesë pranë institucioneve publike dhe private për të cilat pretendoi se subjekti i rivlerësimit ishte në pamundësi për t'i paraqitur ato. Në përfundim të seancës dëgjimore përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
11. Trupi gjykues diskutoi lidhur me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit referuar rezultateve të hetimit, si dhe kërkesës së përfaqësuesit ligjor gjatë seancës dëgjimore publike të datës 13.12.2023 për të kërkuar marrjen e provave shtesë. Në datën 14.12.2023, trupi gjykues vendosi në dhomë këshillimi të riçelë hetimin administrativ për të kërkuar pranë Bankës së Shqipërisë dhe bankës së nivelit të dytë dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm në funksion të një vendimmarrjeje të drejtë, si dhe konsideruar faktin që këto prova nuk u paraqitën nga vetë subjekti i rivlerësimit.

12. Pas riçeljes së hetimit administrativ dhe marrjes së dokumentacionit shtesë provues, trupi gjykues u mblodh në dhomë këshillimi në datën 8.1.2024 për të diskutuar dhe vlerësuar dokumentet provuese të administruara pas riçeljes së hetimit administrativ, si dhe rezultatet përfundimtare të hetimit. Në përfundim, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimin administrativ dhe të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Zena Lila.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT

13. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë sipas bindjes së tyre të brendshme çdo *indicie* në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

14. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të pabazuar në përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse¹.

15. Bazuar në nenet 45,49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar nga institucionet ligjzbatuese sipas përcaktimeve ligjore;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga KLP-ja, së bashku me materialin shoqërues;
- d) dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit shkresor, elektronik dhe gjatë seancës dëgjimore;
- e) deklaratimet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- ë) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- f) denoncimet nga publiku.

A. VLERËSIMI I PASURISË

16. Në Deklaratën e pasurisë *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vijon:

17.1 Shtëpi banimi e përbërë nga dy dhoma e një kuzhinë me sipërfaqe 99.9 m², blerë me Kontratën e datës 22.12.2011, ndodhur në rrugën “***”, pallati “***” sh.p.k., kati ***, ap. ***, ***, ***, Tiranë. Vlera e deklaruar e pasurisë është 61.480 (gjashtëdhjetë e njëmijë e katërqind e tetëdhjetë) euro. Subjekti ka përcjellë² Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2011, të kësaj pasurie të paluajtshme, hartuar përpara noterit.

17.2 Burimet e krijimit të pasurisë të deklaruar në Deklaratën *Vetting* janë:

- a) të ardhura nga shitja e një shtëpie në Gramsh në vitin 2005, në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë;
- b) të ardhurat e krijuara nga shitja e një garazhi, një magazine, sipërfaqeje ndihmëse, si dhe një pjese toke në vlerën 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë;
- c) të ardhura dhe kursimet, si dhe interesat bankarë nga viti 1997.

¹ Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese: “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi”.

² Dosja e ILDKPKI-së Aneks nr. ***.

17.3 Në lidhje me shitjen e shtëpisë në Gramsh, Drejtoria Vendore e ASHK-së Gramsh ka përcjellë³ dosjen e pasurisë prej së cilës rezulton se bëhet fjalë për pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe totale 247 m², nga kjo sipërfaqe trualli 247 m² dhe sipërfaqe ndërtese 92.71 m², e ndodhur në zonën kadastrale ***. Kjo pasuri ka qenë pronë e Entit Kombëtar të Banesave dhe në vitin 2002⁴ është përfituar nga shtetasit M. L., R. L. dhe Zena Lila.

17.4 Shtetasit R. L., M. L. dhe Zena Lila e kanë shitur këtë pasuri në vitin 2005⁵ tek shtetasi G. B. për vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.9.2023, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.8.2023, sipas së cilës znj. R. Z. (L.) nuk ka përfituar të ardhura nga shitja e pasurisë në vitin 2005 duke qenë se ishte martuar dhe nisur nga marrëdhëniet familjare vëlla e motër nuk është hartuar ndonjë dokument në lidhje me heqjen dorë prej këtyre të ardhurave në këtë periudhë. Nga vlerësimi i këtyre dokumenteve rezulton se deklarata noteriale e motrës R. Z., si më sipër, përbën një akt të njëanshëm heqje dorë nga çdo pretendim pronësie apo kompensimi në vlerë monetare, ndaj në analizën financiare si burim të ardhurash për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj është konsideruar vlera e plotë e përfituar nga shitja e kësaj pasurie në vitin 2005 në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

17.5 Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga shitja e një garazhi, një magazine, sipërfaqeje ndihmëse, si dhe një pjese toke në vlerën 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues/justifikues. Ajo deklaron për herë të parë në Deklaratën *Vetting* këtë të ardhur si burim për krijimin e pasurisë shtëpi banimi, si dhe në sqarimet e dhëna në pyetësorë. Gjatë përgjigjeve të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se magazinat, garazhi dhe sipërfaqet shtesë kanë qenë pjesë e pasurisë së zotëruar prej tyre në Gramsh⁶ të pa dokumentuara.

17.6 Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se subjekti nuk rezulton të jenë deklaruar në DPV-në e vitit 2003 ekzistencën e sipërfaqeve të garazhit, magazinave dhe sipërfaqeve të tjera si pjesë e pasurisë së shitur në Gramsh me sipërfaqe 247 m² truall dhe 92.71 m² ndërtesë. Në Kontratën e Shitjes datë 1.2.2005, po ashtu nuk përmendet sipërfaqja informale e pasurisë.

17.7 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004 (dorëzuar në mars 2005) se ka depozituar në bankë shumën 2.300.000 (dy milionë e treqind mijë) lekë me të ardhura nga shitja e shtëpisë në datën 1.2.2005. Nga verifikimi i llogarive bankare rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka derdhur në Bankën e Kursimeve (sot Raiffeisen Bank) në datën 1.2.2005, shumën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë duke krijuar një depozitë me afat 6-mujor, ndërkohë që në datën 30.12.2004 kishte krijuar një depozitë në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë me afat 6-mujor, të cilat janë bashkuar dhe kanë krijuar gjendjen në shumën 2.300.000 (dy milionë e treqind mijë) lekë.

17.8 Për sa parashtruar më sipër, vlera prej 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekësh nuk është konsideruar në analizën financiare si e ardhur as si burim për banesën me sipërfaqe 99.9 m², duke qenë se ka karakter deklarativ dhe nuk është përcjellë dokumentacion provues për përfitimin e kësaj shume. Vetëm depozitimi i shumës 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë në datën e shitjes së shtëpisë nuk është provë e mjaftueshme e faktit të shitjes së shtëpisë bashkë me sipërfaqen informale të saj prej nga është përfituar vlera prej 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekësh. Gjithashtu, nuk evidentohet as ekzistenca e pasurive informale në asnjë formë: nuk ka foto të pasqyrimin të këtyre ambienteve; në deklaratën fillestare të vitit 2003 kur është evidentuar zotërimi i shtëpisë në Gramsh përmendet vetëm sipërfaqja e regjistruar ligjore e pronës; nuk përmendet sipërfaqja totale as në DPV-në e vitit 2005 kur është shitur pasuria (deklarimi vjetor i vitit 2004), por deklarohet vetëm “*Depozitë bankare në Bankën e Kursimeve me vlerë 2.300.000 (dy milionë e treqind mijë) lekë, me burim shitur shtëpia datë 1.2.2005*”.

17.9 Në lidhje me të ardhurat nga kursimet dhe interesat bankare. Të ardhurat prej kursimeve familjare dhe interesave bankarë nga viti 1997 janë referuar në analizën financiare

³ Shkresë nr. *** prot., datë 9.9.2021.

⁴ Kontratë Shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.7.2002, notere N. Gj. (shkresë nr. *** prot., datë 9.9.2021).

⁵ Kontratë Shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.2.2005, notere K. M.

⁶ Përgjigje 9 e pyetësorit standard.

dhe janë llogaritur si burim për krijimin e shumës me të cilat janë kryer pagesat e shtëpisë në vitin 2008.

17.10 Analiza financiare për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë u bazua në kryerjen e pagesave të kësteve, konkretisht: (a) gjatë vitit 2008 është paguar vlera 55.000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) euro [ekuivalenti në lekë 6.775.038 (gjashtë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tridhjetë e tetë)]; (b) gjatë vitit 2011 është paguar 6.480 (gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë) euro [ekuivalenti në lekë 896.184 (tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër)].

17.11 Nga analiza fillestare financiare⁷ rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare në krijimin fillestar të likuiditeteve në bankë (deri në vitin 2003)⁸, të cilat janë shtuar ndër vite nga interesat dhe depozitime të tjera *cash*. Për sa i përket depozitimeve *cash*, kryer nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, rezultoi se bashkëshorti depozitonte në bankë shuma parash *cash*, për të cilat mbetej i paprovuar burimi i ligjshëm i krijimit të tyre.

17.12 Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit rezultoi të ketë qenë në pamundësi financiare për shtimin e likuiditeteve në bankë në shumën -2.330.231 (dy milionë e treqind e tridhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë në vitet 2004 – 2007 dhe -274.633 (dy milionë e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë në vitin 2011. Subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare në total -2.604.864 (dy milionë e gjashtëqind e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë për krijimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 99.9m², ndodhur në ***, Tiranë, në vlerën 61.480 (gjashtëdhjetë e njëmijë e katërqind e tetëdhjetë) euro.

17.13 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

17.14 Në vijim të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit në prapësimet dhe shpjegimet e saj deklaroi se: *“Së pari do të shpjegoj kronologjinë dhe burimin e shumave të depozituara në bankë nga bashkëshorti M. L., por edhe nga ana ime ... që nga momenti i krijimit të tyre deri në vitin 2008, vit në të cilin është paguar pjesa më e madhe e çmimit të apartamentit që ne kemi në ***... Në DPV-në e vitit 2003, pavarësisht se duhej deklaruar gjendja e pasurive në datën 31.12.2003, nga ana ime është deklaruar gjendja e depozitave të kursimit/likuiditetit në atë kohë në Bankën e Kursimeve në datën 17.3.2004. Pranoj pasaktësinë e mosdeklarimit të pasurive në deklaratën e parë të pasurisë deri në datë 31.12.2003, por duke qenë se kjo DPV është konsideruar edhe deklarim vjetor, por edhe deklaratën e parë të pasurisë e kam pasur të paqartë këtë moment...”*

17.15 Subjekti i rivlerësimit shtoi se: *“Zena Lila ka pasur depozitë në Bankën e Kursimeve, e cila në datën 30.1.2004 ka pasur gjendje shumën 476.278 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë ekzaktësisht sa është deklaruar në DPV-në e vitit 2003 (DPV e cila është dorëzuar në datën 24.3.2004); M. L. në Bankën e Kursimeve në datën 17.3.2004 ka depozituar shumën 1.868.587 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, shumë e cila është depozituar pasi në të njëjtën datë është mbyllur një depozitë tjetër, e cila vjen që nga viti 1998 në shumën 668.587 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë. Pra, gjendja e likuiditetit në datën 17.3.2004 është në shumën 2.329.740 (dy milionë e treqind e njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë. Burimi i likuiditetit gjendje në datën 17.3.2004 janë të ardhurat nga pagat që nga viti 1993, të ardhurat nga interesa bankarë, por edhe një dhuratë nga vëllai i M. L., shtetasi F. L., në shumën 3.500 (tre mijë e pesëqind) dollarë ashtu siç është deklaruar edhe në DPV-në fillestare, ashtu edhe në Deklaratën Vetting”*.

17.16 Subjekti ka paraqitur variantin e saj të analizës kumulative për periudhën 1993 – 17.3.2004, duke kërkuar të përfshihen këtu: (a) të ardhurat e bashkëshortit në vitet 1992 – 1997, sipas vërtetimeve të Drejtorisë së Policisë Vendore Elbasan; (b) dhurata nga vëllai në vlerën

⁷ Referojuni analizës financiare për periudhën 1993 – 2003.

⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2021, të Raiffeisen Bank.

3.500 (tre mijë e pesëqind) USD; (c) llogaritja e shpenzimeve jetike gjatë viteve 1993 – 1999 në masën 30% të të ardhurave, meqenëse si vetë dhe bashkëshorti kanë pasur paga më të larta sesa mesatarja në qytetin e Gramshit në këtë periudhë; (ç) likuiditeti sipas gjendjes së datës 17.3.2004, si deklaruar më sipër prej saj. Sipas analizës financiare të përgatitur nga subjekti, për çdo vit rezulton me gjendje pozitive përveç vitit 2000, ku del një gjendje negative prej 42.543 (dyzet e dy mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekë⁹.

17.17 Sqarimet e subjektit për gjendjen e likuiditeteve gjatë viteve 2004 – 2008 po i paraqesim në mënyrë të përmbledhur si në vijim: “...gjendja e likuiditetit në fund të vitit 2004 e familjes Lila ka qenë në shumën 3.022.595 (tre milionë e njëzet e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë. Shtesa në llogarinë bankare ka si burim të ardhurat nga pagat dhe të ardhurat nga interesat bankarë ... Gjatë vitit 2005 janë tërhequr kryesisht depozita nga Banka e Kursimeve dhe gjendja në fund të vitit 2005 e likuiditeteve të familjes Zena dhe M. L. ... në fund të vitit 2005 (shto disa shuma fare të vogla në disa llogari të tjera) është në shumën 5.414.193 (pesë milionë e katërqind e katërbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë... burimi i shtesës së likuiditetit në vitin 2005 ka si burim kursimet nga pagat të ardhurat nga interesat dhe të ardhurat nga shitja e banesës... Në datën 1.2.2005, bashkëshortët M. L. dhe Zena Lila shesin shtëpinë dhe magazinën në vlerën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë dhe këtë shumë së bashku me 100.000 (njëqind mijë) lekë kursime familjare e depozitojnë në Bankën e Kursimeve po në datën 1.2.2005, në shumën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë, shumë e cila kalohet në llogarinë me nr. ***, në Raiffeisen Bank në datën 11.3.2005. Më pas, kjo shumë investohet në depozitë me afat në Raiffeisen Bank, depozitë e cila maturohet në datën 1.8.2005, në shumën 1.738.332 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë dhe kjo shumë tërhiqet në datën 4.8.2005 dhe së bashku me shumën e tërhequr nga llogaria e Zena Lilës, po në datën 4.8.2005 depozitohet në OTP Bank në shumën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

Gjendja e likuiditetit në fund të vitit 2006 është në shumën 6.165.043 (gjashtë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyzet e tre) lekë. Pra, gjatë vitit 2006, depozitë e re është vetëm depozita e çelur në datën 28.12.2006, e cila ka si burim kursimet nga paga. Depozitat e tjera janë shtruar vetëm për shkak të interesave bankarë. Gjendja e likuiditetit në fund të vitit 2007 është në shumën 7.288.937 (shtatë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë) lekë. Për vitin 2007 ka pasur shtim likuiditeti vetëm në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, ku në kohën e shtimit të likuiditetit kjo familje ka pasur mundësinë për të kursyer shumën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë... Në vitin 2007 shtohet edhe një gjendje cash në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë... Në vitin 2008, i gjithë likuiditeti i gjendur në bankë tërhiqet dhe vetëm shtohet gjendja e likuiditetit në shtëpi me shumën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë”.

17.18 Në analizë financiare Komisioni ka konstatuar diferencë negative për pamundësi shtim likuiditeti për vitet 2005, 2007 dhe 2011. Për vitin 2005 historiku i krijimit dhe lëvizjeve të depozitave që përbejnë likuiditetin u shpjegua më lart, pasi për llogaritjet referuan deri në vitin 2008 dhe provohet që nuk ekzistojnë pamjaftueshmëri për shtimin e likuiditetit në vitin 2005. Për vitin 2007 rezulton se bashkëshortët M. L. dhe Zena Lila kanë pasur të ardhura nga pagat në vlerën 1.182.414 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e katërbëdhjetë) lekë. Shpenzimet kanë qenë në vlerën 606.480 (gjashtëqind e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë. Pra, kjo familje ka pasur mundësi për të kursyer në vlerën 575.934 (pesëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë.

17.19 Subjekti ka kërkuar të përfshihet në analizë financiare gjithë vlera e shitjes së shtëpisë në Gramsh në vitin 2005, përfshirë edhe pjesën informale në vlerën totale prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh, duke argumentuar se: “Së dyti, vlerësoj se 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë nuk është në nivel deklarativ. Shuma e shënuar në kontratën e shitblerjes për pjesën e pasurisë së regjistruar në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë dhe

⁹ Referojuni prapësimeve me shkrim të paraqitura nga subjekti në datën 7.12.2023.

shuma e paguar për pjesën e paregjistruar të pronës, në vlerën 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë, janë paguar në të njëjtën datë nga blerësi G. B.. Shuma në total prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh është depozituar nga G. B. në llogari te M. L. në Raiffeisen Bank. Shumës prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh i është shtuar dhe 100.000 (njëqind mijë) lekë nga M. L., nga kursime të vitit, dhe kjo shumë është vendosur në të njëjtën datë në depozitë me afat 6-mujor nga M. L. në Raiffeisen Bank. Pra, depozita në vlerën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë ka si burim çmimin e shitjes së banesës, paguar nga G. B.. në vlerën 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë dhe shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë, shtuar nga M. L. nga kursimet familjare të atij viti. Këtë fakt e provon më së miri depozita me afat në Raiffeisen Bank, e çelur në datën e shitjes së banesës në qytetin e Gramshit me kontratë shitblerjeje. Këto veprime ndërmjet shtetasve G. B.. dhe M. L. janë kryer në rrugë bankare. Deklarimi i kësaj shume nuk është deklaruar vetëm në Deklaratën Vetting, pasi shitja e shtëpisë është deklaruar në deklaratën e vitit 2004, e cila dorëzohet në fund të muajit mars të vitit 2005... Kjo shumë duhet të përfshihet në analizë financiare, pasi është provuar që vjen nga një burim i ligjshëm... Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore ashtu siç është konsoliduar praktika në jurisprudencën e trupave të rivlerësimit, detyrimi tatimor për shitjen e pasurive të paluajtshme kryhet në momentin e regjistrimit të pasurisë në ZRPP. Në lidhje me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës theksoj se prona objekt shitjeje nuk është pasuri e regjistruar dhe, si rrjedhojë, detyrimi tatimor për këto të ardhura do të paguhej vetëm nëse pasuritë e paluajtshme do të regjistroheshin dhe do të përpilohej kontrata e shitblerjes, fakt i cili nuk ndodhi sepse këto pasuri nuk u regjistruan asnjëherë. Sjell në vëmendje të Komisionit vendimin nr. 29, datë 21.7.2022, të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit E. D., që ka trajtuar gjerësisht një rast të ngjashëm dhe ka vendosur se detyrimi për të paguar detyrimin tatimor lind në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes dhe regjistrimit të pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Në kushtet kur kontrata e shitblerjes nuk është lidhur ende, nuk ka lindur ende detyrimi për të paguar detyrimin tatimor". Pretendimit për pagimin e shumës 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë nga shtetasi G. B., subjekti i ka bashkëlidhur edhe Deklaratën Noteriale nr. ***, datë 27.1.2022, (noter K. K.) nga shtetasi G. B., ku deklarohet se në vitin 2005 babai i tij ka blerë nga familja e shtetasit M. L. pasurinë në Gramsh, ku, përveç sipërfaqes së dokumentuar me dokument pronësie, është blerë edhe një copë truall me sipërfaqe 200 m², si dhe pjesë godine si garazh, magazinë dhe materiale ndërtimi, për të cilat nuk disponohej dokument. Për këto objekte (të dokumentuara dhe të padokumentuara) është paguar në total vlera 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë, ku 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë kanë kaluar nëpërmjet bankës dhe 200.000 (dyqind mijë) lekë është paguar *cash*.

17.20 Këto pretendime u paraqitën edhe në seancën dëgjimore të datës 13.12.2023. Vlen të theksohet mospërputhshmëria e deklarimeve të subjektit në seancë dhe në prapësime të paraqitura nga vetë ajo, në lidhje me evidentimin e shumës 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë të përfituara nga shitja e shtëpisë në Gramsh. Nëse në prapësimet e paraqitura me shkrim thekson se veprimet ndërmjet bashkëshortit të saj dhe blerësit G. B. janë kryer në rrugë bankare, në seancë përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit pretendoi se shuma 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë ka qenë gjendje në llogarinë e shtetasit G. B., ku është tërhequr *cash* dhe i është paguar *cash* shtetasit M. L., së bashku me 200.000 (dyqind mijë) lekë që i kishte jashtë sistemit bankar. Pretendimit për ekzistencën e kësaj gjendjeje lekësh në llogarinë e shtetasit G. B., përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit i bashkëlidhi korrespondencën me punonjës in e Raiffeisen Bank, sipas së cilës vetë subjekti nuk mund të kërkonte informacion për shtetasin G. B.. duke qenë se përbënte "sekret bankar". Nga ana tjetër, Komisioni kishte të drejtë ta siguronte këtë informacion, i legjitimuar nga ligji nr. 84/2016.

17.21 Në funksion të marrjes së një vendimi të drejtë dhe për të provuar pretendimet e subjektit, Komisioni vendosi të riçelë hetimin administrativ për të siguruar informacionin e nevojshëm nga Raiffeisen Bank në lidhje me gjendjen e llogarisë së shtetasit G. B. në momentin e shitblerjes së pasurisë në Gramsh. Pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve të subjektit të paraqitura më sipër, rezultoi sa vijon.

17.22 Lidhur me pasaktësinë e deklaramit në DPV-në e vitit 2003 të depozitës në emër të bashkëshortit në vlerën 1.868.587 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, që është pranuar nga subjekti si pasaktësi, Komisioni vlerësoi se kemi të bëjmë me pasaktësi dhe mosnjohje të saktë të procesit të deklaramit, duke qenë se e njëjta situatë paraqitet edhe në deklaramin e vitit 2004, ku subjekti ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve deri në mars të vitit 2005 dhe jo deri në dhjetor të vitit 2004, siç kërkohet nga ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar. Konstatohet se kjo pasaktësi, ndonëse është e tillë sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, nuk është bërë me qëllim për të fshehur gjendjen e pasurisë së subjektit dhe nuk afekton ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume. Për këtë arsye, Komisioni gjykoi të përfshijë në analizën financiare gjendjen e likuiditeteve sipas dokumentacionit të paraqitur gjatë hetimit administrativ, duke konsideruar edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi pasaktësitë në deklaramin. Nga kjo analizë ndryshoi gjendja e likuiditeteve të subjektit gjatë vitit 2004, duke afektuar edhe gjendjen e subjektit në vijim.

17.23 Në lidhje me burimin e të ardhurave të shumës 1.868.587 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë subjekti pretendoi se ky likuiditet buron nga të ardhurat nga pagat dhe një pjesë e vogël nga dhurata në vlerën 3.500 (tre mijë e pesëqind) USD e vëllait F. L., i vendosur në SHBA. Pretendimit për përfshirjen në këtë analizë si burim të ardhurash të vlerës së dhënë hua nga kunati F. L., subjekti i ka bashkëlidhur deklaratat e tatimit mbi të ardhurat e kunatit për vitet 2001 – 2002, të lëshuara elektronikisht nga Departamenti i Thesarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në bazë të deklaratës së tatimit mbi të ardhurat e kunatit File Lila konstatohet se të ardhurat e tij bruto gjatë vitit 2002 janë 83.701 (tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e një) USD, ndërsa gjatë vitit 2001 janë 75.755 (shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e pesë) USD.

17.24 Rezulton se prova e paraqitur nuk është në formën e kërkuar nga ligji. Dokumentet janë përkthyer në Shqipëri dhe vërtetohet me akt noterial përkthimi i tyre, por janë elektronike e nuk përmbajnë vulë apostile, e cila në bazë të Marrëveshjes së Hagës (1961) certifikon autenticitetin e një dokumenti të lëshuar nga një autoritet shtetëror për përdorim në një shtet tjetër kur të dyja shtetet midis tyre kanë ratifikuar Marrëveshjen e Hagës (në rastin konkret Shqipëri-SHBA). Po t’i referohemi deklaramit fillestar të vitit 2003 në ILDKPKI, konstatojmë se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të depozitës në emër të bashkëshortit në vlerën 1.868.587 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë të ardhurat nga pagat dhe një pjesë e vogël dhuratë nga vëllai i tij në SHBA. Pra, që në vitin 2003 subjekti është munduar ta evidentojë këtë burim të ardhurash në gjurmët e deklarimeve periodike.

17.25 Nisur nga sa rezulton më sipër, trupi gjykues vlerëson se shuma 3.500 (tre mijë e pesëqind) USD, si dhuratë e vëllait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, duhet të konsiderohet si burim i këtij likuiditeti, e parë në vlerësim proporcional dhe objektiv në disa drejtime, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit¹⁰. *Së pari*, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 konstatohet se vëllai i bashkëshortit të subjektit ka konfirmuar me deklaratë noteriale se në gusht të vitit 2002 i ka dhuruar z. M. L. 3.500 (tre mijë e pesëqind) USD, të përfituara nga të ardhurat e siguruara nga puna e tij në emigracion¹¹. *Së dyti*, po në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 mbi justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të kësaj shume nga ana e z. F. L., duket se ky i fundit ka pasur mundësi të krijojë të ardhura dhe t’i deklarojë ato në organet tatimore sipas legjislacionit vendas, duke iu nënshtruar për këtë shkak edhe ndalesave tatimore përkatëse. *Së treti*, nga ana e subjektit të rivlerësimit është deklaruar në vitin e largët 2003 në deklaramin periodik vjetor se burim i krijimit të shumës së depozitës prej 1.868.587 lekë në emër të bashkëshortit midis të tjerave shërben edhe dhurata

¹⁰ Vendim nr. 15/2021, (JR) 46/2019 regjistër, paragrafi 24.3.

¹¹ Deklaratë Noteriale nr. ***, datë 1.2.2021 (noter B. J. A.) përgjigje e pyetjes 4 të pyetësorit standard.

Neni 32/4 i ligjit nr. 84/2016 përcakton se: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”. Sipas kësaj dispozite, kriteri i parë i krijimit të një marrëdhënieje dhurimi/huadhënie është konfirmimi i dhurimit ose huas së dhënë dhe kriteri i dytë lidhet me justifikimin e ligjshmërisë së burimit të shumës së dhënë”.

nga vëllai në SHBA. Kjo përbën provë në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016¹². Përveç sa më sipër, ka të bëjë edhe fakti që kjo shumë nuk e nxjerr subjektin nga ndonjë situatë negative financiare për vitin 2003 – 2004, duke qenë se edhe në analizën fillestare financiare, nuk ka rezultuar pamjaftueshmëri e subjektit të rivlerësimit dhe familjes së saj për pasuritë e krijuara gjatë këtyre viteve.

17.26 Në lidhje me shpenzimet jetike, në analizën e mëparshme financiare shpenzimet ishin përlllogaritur me 66% të të ardhurave duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ishte në detyrë si prokurore dhe për bashkëshortin e saj nuk kishte informacion mbi të ardhurat e gjeneruara prej tij gjatë viteve 1993 – 1997. Në prapësime, subjekti paraqiti si provë të ardhurat e bashkëshortit sipas vërtetimeve të Drejtorisë së Policisë Vendore Elbasan¹³, po ashtu edhe subjekti i rivlerësimit për shkak të pozicionit të detyrës si ndihmës gjyqtare ka realizuar të ardhura në vlerë më të lartë sesa 800 (tetëqind) USD/vit. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përlllogaritjen e shpenzimeve jetike me 30% të të ardhurave, meqenëse të dy bashkëshortët kanë pasur të ardhura më të larta sesa mesatarja e pagave sidomos në qytetin e Gramshit, vlerësohet se është një pretendim i pranueshëm në frymë të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit referuar vendimit nr. 15/2021¹⁴, (cit): *“Nga një vështrim i thjeshtë i të dhënave që disponohen nga burime të hapura, për pagat në vend në këtë periudhë rezulton se raporti i pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve me ato të funksionarëve të tjerë të sektorit publik, qëndronte përafërsisht në raportin rreth 30% më të larta. Në këto kushte, duke marrë parasysh këtë raport, krahasuar me informacionin që jep Banka e Shqipërisë në raportin e vitit 1995 të cituar më lart, vlerësohet se në rastin e analizës financiare në të cilat figurojnë të ardhura të siguruara nga puna e gjyqtarëve apo prokurorëve, shpenzimet e jetesës duhet të llogariten në masën 30% të të ardhurave, i cili përaftron me masën e shpenzimeve për jetesë në raportin 66% të të ardhurave që i përkasin pagave mesatare të të gjithë sistemit të pagave. Logjika që mbështet këtë konkluzion vjen si pasojë e arsytimit ligjor se standardi për shpenzimet e jetesës duhet të jetë i njëjtë për shtetasit dhe subjektet e rivlerësimit, për sa kohë që nuk rezultojnë të dhëna zyrtare, të cilat do të përcaktonin ndryshe... Organet e rivlerësimit sigurisht që duhet të kryejnë një analizë logjike e të arsyeshme për përlllogaritjen e këtyre shpenzimeve në raste në të cilat ndërthuren elemente të tjera, duke mbajtur në çdo rast në konsideratë se masa prej 66% e shpenzimeve në raport me të ardhurat nga punësimi para vitit 2000 do të merrte kuptim vetëm kur të trajtoheshin të ardhura mesatare të sektorit publik që shkojnë përafërsisht në vlerën rreth 800 USD/vit, sipas referencës së Bankës së Shqipërisë, dhe duke e vlerësuar këtë orientim në drejtim të përcaktimit të një analize logjike dhe jo si një referim ligjor të detyrueshëm për zbatim”.*

17.27 Në lidhje me gjendjen e likuiditeteve bankare të vitit 2005 – subjekti pretendon përfitimin e shumës 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekë nga shitja e shtëpisë në Gramsh, për shkak të përfshirjes në këtë shitje edhe të sipërfaqeve të padokumentuara ndërtime dhe truall. Ky pretendim nuk u arrit të provohej nga subjekti me dokumentacion pas kalimit të barrës së provës, si dhe në shqyrtim të të gjithë dokumentacionit të analizuar gjatë hetimit nuk rezulton asnjë gjurmë e sipërfaqes informale në posedim sa pretenduar nga subjekti. Kontrata e Shitjes datë 1.2.2005 referon vetëm sipërfaqen e dokumentuar të pronës, po ashtu edhe vlera e shitjes e reflektuar si në kontratën e shitjes edhe në ZVRPP është 500.000 (pesëqind mijë) lekë aq sa është përlllogaritur në analizën financiare të njësisë ligjore. Në DPV-të vjetore të viteve 2003, 2004 apo 2005 nuk përmendet ekzistenca e sipërfaqes informale të pronës. Në DPV-në e vitit 2003 deklarohet zotërimi i pasurisë së paluajtshme në Gramsh, por vetëm sipërfaqja e dokumentuar e pronës truall dhe ndërtesë, ish-objekt ushtarak, përfituar me privatizim nga EKB-ja. Në DPV-në e vitit 2004 subjekti deklaroi *“Depozitë bankare në Bankën e Kursimeve Gramsh, në vlerën 2.300.000 (dy milionë e treqind mijë) lekë me burim shitur shtëpia”*, pa specifikuar nëse bëhej fjalë për shitjen e objektit formal dhe informal bashkë. Shpjegimet për shitjen e sipërfaqes informale në vlerën e saj prej 1.100.000 (një milion

¹² Neni 32/5 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: *“Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit”.*

¹³ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare prej 8.8.1992 deri më 28.2.1997 nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan.

¹⁴ Vendim nr. 15/2021 subjekti K. S., paragrafët 21.41 dhe 21.42.

e njëqind mijë) lekësh e ka dhënë vetëm në Deklaratën *Vetting*, ku duket sikur është munduar të justifikojë burimin e pasurisë apartament që zotëron në Selitë.

17.28 Pas riçeljes së hetimit administrativ u sigurua dokumentacion nga Raiffeisen Bank¹⁵ në lidhje me gjendjen e llogarisë bankare të shtetasit G. B., prej ku rezultoi se në llogarinë e tij në Bankën e Kursimeve, dega Gramsh, figuroi vetëm një depozitë prej 4.200 (katër mijë) euro, e cila është tërhequr nga llogaria në datën 15.12.2004.

17.29 Nuk konstatohet tërheqje e shumës 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë apo e një vlere të përafërt nga ana e këtij shtetasi apo e familjarëve të tij¹⁶ në datën 1.2.2005, në momentin e shitblerjes së shtëpisë në Gramsh. Pretendimet e subjektit nuk u provuan me dokumentacion edhe pas riçeljes së hetimit administrativ. Duke konsideruar të gjitha provat dhe pretendimet, nuk ka rrethana që mund të dokumentojnë ekzistencën e shitjes së 200 m² truall, së bashku me sipërfaqe ndërtimore të paregjistruara dhe përfitimin e vlerës 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë në vitin 2005. Vetëm deklarimi i depozitës me vlerë 2.300.000 (dy milionë e treqind mijë) lekë në DPV-në e vitit 2004¹⁷ me burim shitjen e shtëpisë, është i pamjaftueshëm në kuptim të vlerës së provës për të argumentuar ekzistencën e këtyre sipërfaqeve dhe vlerën e pretenduar prej 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekësh për shitjen e tyre. Në këto kushte, burimi i të ardhurave prej 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekësh mbeti i paprovuar prej subjektit të rivlerësimit apo nga shqyrtimi i dokumentacionit të siguruar gjatë hetimit administrativ, ndaj nuk është konsideruar nga Komisioni në analizën e rishikuar financiare.

17.30 Pretendimet e subjektit për likuiditetet bankare të zotëruara dhe ndryshimet që ato kanë pësuar gjatë viteve 2005 – 2008 përputhen përafërsisht edhe me verifikimet e kryera nga njësia ligjore me përjashtim të ndryshimeve të gjendjeve të likuiditete të pasqyruara në vitin 2003, të cilat nuk janë deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2003 dhe në DPV-në e vitit 2004, vit në të cilin nuk përcillej informacion i plotë nga Raiffeisen Bank. Në analizë financiare janë konsideruar vlerat dhe gjendjet e verifikuara sipas dokumentacionit financiar të shqyrtuar.

17.31 Nga dokumentacioni i përcjellë dhe shpjegimet përkatëse rezultoi se në datën 17.3.2004 shtetasi M. L. çel depozitën me shumë 1.868.587 (një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë me burim: (a) kursimet nga pagat nga viti 1993; (b) tërhequr në të njëjtën datë 17.3.2004 shuma 660.711 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekë + interesa e cila është nga viti 2003; (c) dhuratë nga vëllai i z. M. L. në shumën 3.500 (tre mijë e pesëqind) USD. Nga rishikimi i analizës financiare të kryer nga Njësia Ligjore rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për shtimin e likuiditeteve në bankë në vitin 2004, konkretisht për çeljen e depozitës në datat 17.3.2004 dhe 24.12.2004.

17.32 Nga dokumentacioni i përcjellë nga Raiffeisen Bank rezultoi se në datën 1.2.2005 z. M. L. çel depozitë në shumën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë. Në këtë datë është realizuar dhe shitja e pasurisë në Gramsh, ku të ardhurat e përfituara nga shitja e saj, pa deklaruar shumën përkatëse të përfituar, si dhe të ardhurat nga paga, kanë shërbyer si burim për shtimin e likuiditeteve në bankë.

17.33 Duke qenë se për krijimin e pasurisë shtëpi banimi të deklaruar në Deklaratën *Vetting* me sipërfaqe 99.9 m² rezultoi që për pagesat e kryera në vitin 2008 si burim kanë shërbyer likuiditetet bankare, pas rishikimit të analizës financiare, prapësimeve të subjektit dhe seancës dëgjimore, përfundimisht rezultoi se për krijimin dhe shtimin e tyre subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj rezultuan në pamundësi financiare në vlerën 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë për krijimin e depozitës në vlerën 1.700.000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë në

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2023, e Raiffeisen Bank.

¹⁶ Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 21.12.2023 dhe shkresës nr. *** prot., datë 4.1.2024, nga Raiffeisen Bank.

¹⁷ Depozituar në bankë në datën 1.2.2005, vlera 1.700.000 lekë dhe 600.000 lekë më 24.12.2004, deklaruar në DPV-në e vitit 2004, datë 24.3.2005.

datën 1.2.2005, e cila rezulton të ketë ardhur për shkak të mosprovimit me dokumentacion të shitjes së pjesëve të padokumentuara të shtëpisë në Gramsh.

17.34 Gjendja negative financiare e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për krijimin e pasurisë shtëpi banimi me sipërfaqe 99.9 m² paraqitet në këtë mënyrë: pamundësi financiare në fund të vitit 2005 në vlerën -1.037.583 (një milion e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë e krijuar për shkak të mosprovimit me dokumentacion të burimit të shitjes së sipërfaqes së padokumentuar të shtëpisë në Gramsh dhe gjendja negative në vitin 2011 prej -11.503 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tre) lekësh.

17.35 Në lidhje me këtë pasuri Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “a”, pasi nuk u arrit të provohet në sajë të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe atij të siguruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ ekzistenca e vlerës 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë si burim i të ardhurave nga shitja pa dokumentacion e një pjesë toke, magazinat, sipërfaqe ndihmëse dhe një garazh si pjesë e shtëpisë në Gramsh. Ajo ndodhet gjithashtu në pamundësi financiare me burime të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në shumën -1.037.583 (një milion e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e tre) lekë.

17.36 Kjo situatë negative financiare do të vlerësohet nga ana e Komisionit në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në zbatim të parimeve të proporcionalitetit dhe objektivitetit.

18. Llogaria rrjedhëse ku kreditohet paga në Credins Bank, gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 0 (zero) lekë

18.1 Credins Bank¹⁸ konfirmon balancën e llogarisë në datën 27.1.2017. Nga verifikimet përputhet deklarimi i subjektit në Deklaratën Vetting me dokumentacionin përcjellë nga Credins Bank.

19. Automjet tip “Ford Fusion” e përfituar me Kontratë Shitblerjeje në vitin 2014 me burim të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit. Zotëron: 50% të pasurisë. Vlera e deklaruar e pasurisë është 3.000 (tre mijë) euro.

19.1 Në DPV-në e vitit 2014 deklarohet blerja e këtij automjeti në vlerën 2.900 (dy mijë e nëntëqind) euro.

19.2 DPSHTRR-ja¹⁹ ka përcjellë pranë Komisionit dosjen e automjetit të regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Sipas Kontratës së Shitblerjes nr. ***, datë 10.10.2014, automjeti është shitur për 3.000 (tre mijë) euro, e cila është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Mandatpagesë nuk është paraqitur. Kontrata është lidhur përpara noterit E. K. në Shijak mes shitësit K. M. dhe blerësit M. L.. Nga deklarata e zhdoganimit rezulton që shtetasi K. M. e ka përfituar nga një eksportues i huaj për vlerën 700 (shtatëqind) euro, si dhe taksa e zhdoganimit prej 24.294 (njëzet e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër) lekësh.

19.3 Nga sistemi TIMS nuk konstatohen lëvizje me këtë automjet. Janë verifikuar në AMF policat e sigurimit të prera për këtë automjet dhe rezulton që polica e parë të jetë prerë pasi është blerë, në datën 20.10.2014. Ky automjet ka pasur siguracion të prerë deri në vitin 2022, vit pas të cilit nuk rezulton të jetë përdorur më. Të njëjtën gjë ka deklaruar edhe subjekti në pyetësorin dërguar Komisionit²⁰. Nga të dhënat e dosjes së referuar nga DPSHTRR-ja rezulton se automjeti është shitur në vitin 2021.

19.4 Komisioni ka përgatitur analizën financiare për blerjen e automjetit në datën 10.10.2014, në shumën 3.000 (tre mijë) euro ose ekuivalentin në shumën 420.330 (katërqind e njëzet mijë e treqind e tridhjetë mijë) lekë. Analiza financiare iu referua të ardhurave nga pagat dhe interesat bankarë, nga ku subjekti i rivlerësimit rezulton se ka mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 12.4.2021.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.9.2023.

²⁰ Referojuni përgjigjeve të pyetësorit nr. *** prot., datë 8.9.2023.

19.5 Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.

20. Depozitë bankare në Bankën e Shqipërisë – Bono Thesari në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me burim kursimet nga paga e saj si prokurore dhe ajo e bashkëshortit si mjek.

20.1 Nga verifikimi në bankë rezulton se:

- a) në datën 17.6.2010 nga banka ICB (Union Bank) është transferuar për blerje Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë nga z. M. L. shuma 1.000.000 (një milion) lekë, gjendja e likuiditeteve në Bankën e Shqipërisë në datën 31.12.2010 është në shumën 1.000.000 (një milion) lekë në emër të z. M. L.;
- b) është çelur Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë në datën 1.2.2011, në shumën 1.000.000 (një milion) lekë në emër të z. M. L. dhe në datën 23.6.2011 është transferuar nga banka ICB (Union Bank) nga llogaria e z. M. L. shuma 500.000 (pesëqind mijë) lekë;
- c) depozitim *cash* në datën 15.6.2012 nga z. M. L. në llogarinë e pagës te Credins Bank në shumën 500.500 (pesëqind mijë e pesëqind) lekë dhe transferim për Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë;
- ç) depozitim në llogarinë te Fibank, në emër të z. M. L. në datën 15.1.2013, shuma 500.500 (pesëqind mijë e pesëqind) lekë dhe transferim në Bono Thesari te Banka e Shqipërisë, në emër të z. M. L.;
- d) gjendja e likuiditeteve në Bankën e Shqipërisë në datën 31.12.2013 është në shumën 3.500.000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë (plus shtesë nga interesa) në emër të z. M. L.. Në vitet 2014 – 2016, nga verifikimi rezulton se ka ndryshim në likuiditetet në Bankën e Shqipërisë vetëm shtesë nga interesat bankarë.

20.2 Më poshtë është pasqyruar gjendja e likuiditeteve Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë dhe mundësia financiare për përballimin e tyre me të ardhurat nga paga:

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjendje likuiditete në bankë, BTH	1.000.000	2.500.000	3.000.000	3.500.000			3.860.000
Interesa bankarë			64.177	65.304	91.838	160.034	37.566
Shtesa nga depozitim <i>cash</i> në llogari dhe transferim në BTH		1.500.000	500.000	500.000			
Mundësia financiare	- 636.063 ²¹	-1.027.326 ²²		-402.431 ²³			

20.3 Nga hetimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të (bashkëshorti) rezultoi se bashkëshorti derdh në bankë të ardhura për krijimin e këtyre depozitave dhe nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor rezultoi mungesë likuiditetesh për krijimin e tyre, konkretisht për krijimin e kësaj depozite në vitin 2010 në shumën -636.063 (gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë, shtimit të saj në vitin 2011, në shumën -1.027.326 (një milion e njëzet e shtatë mijë e treqind e njëzet e gjashtë) lekë dhe shtimit në vitin 2013 në shumën - 402.431 (katërqind e dy mijë e katërqind e tridhjetë e një) lekë. Subjekti i rivlerësimit rezultoi në pamundësi financiare në shumën - 2.065.820 (dy milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëzet) lekë për krijimin e gjendjes në Bono Thesari²⁴ në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, deklaruar në Deklaratën *Vetting*.

20.4 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

20.5 Në vijim të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit me prapësimet dhe shpjegimet e saj deklaroi se: “Për vitin 2010, me datë 17.6.2010, është bërë transfertë bankare nëpërmjet (ICB) sot Union Bank, në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë dhe është bërë transfertë nëpërmjet kësaj

²¹ Mundësia financiare për krijimin e Bonove të Thesarit në datën 17.6.2010, në shumën 1.000.000 lekë.

²² Mundësia financiare për krijimin e Bonove të Thesarit në datën 1.2.2011, në shumë 1.000.000 lekë -883.800 lekë dhe për shtesë në datën 23.6.2011 në shumën 500.000 lekë -143.523 lekë.

²³ Mundësia financiare për shtesë në Bono Thesari në datën 15.1.2013, në shumën 500.000 lekë.

²⁴ Për më shumë referuar tabelës së përgjithshme të analizës financiare.

banke tek Banka e Shqipërisë për blerje Bono Thesari, me afat maturimi 1-vjeçar. Si burim për krijimin e kësaj shume janë të ardhurat e kursyera nga familja Lila për vitet 2007, 2008, 2009, gjendje cash në banesë, deklaruar në deklarimet periodike përkatëse. Ku referuar deklarimeve periodike në vitin 2007 gjendja cash ka qenë 500.000 lekë, në vitin 2008 gjendja cash 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, ndërsa në vitin 2009 gjendja cash 900.000 (nëntëqind mijë) lekë, që do të thotë se në fillim të vitit 2010 familja e Zena Lilës kishte kursime cash në banesë në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë. Ky fakt provon se M. L. në datën 17.6.2010 kishte të ardhura nga burime të ligjshme për të krijuar depozitën në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, për blerje Bono Thesari. Këto lekë janë mbajtur në banesë dhe janë deklaruar në deklarimet periodike të viteve 2007, 2008 dhe 2009, ku për vitet përkatëse janë deklaruar vetëm gjendja cash, për secilin vit. Nuk janë vendosur depozitë si në vitet e mëparshme, pasi familja Lila i mbante disponibël për pagimin e këstit të mbetur prej 6.480 (gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë) euro, ku pagimi i këtij kësti diktohej nga momenti që shitësi do të përpilonte kontratën e shitblerjes.

Në vitin 2011, në datën 1.2.2011, është bërë transfertë nëpërmjet bankës së nivelit të dytë në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë dhe është bërë transfertë për Bono Thesari në Bankën e Shqipërisë, me afat maturimi 1-vjeçar, ku kjo vlerë si burim ka të ardhurat e familjes Lila për vitin 2010, si dhe gjendjet cash të viteve të mëparshme, si dhe interesat bankarë....

Duke iu referuar shpjegimeve të lartpërmendura, duke mbajtur në konsideratë të ardhurat dhe shpenzimet e familjes Lila kjo familje ka pasur mundësi për të kursyer shumën e parave cash të deklaruar në deklarimet periodike të çdo viti. Sa më lart nuk ka pasur pamundësi financiare për krijim depozite në vitin 2010 në shumën -636.063 (gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë, si dhe shtimit të saj në vitin 2011 në shumën -1.027.326 (një milion e njëzet e shtatë mijë e treqind e njëzet e gjashtë) lekë dhe shtimit në vitin 2013 në shumën -402.431 (katërqind e dy mijë e katërqind e tridhjetë e njëmijë) lekë. Analiza financiare e bërë nga këshilltarët ekonomikë të Komisionit është hipotetike, por edhe për shkak të mospërllogaritjes si duhet të gjitha interesave sidomos nga Bonot e Thesarit. Në vitin 2010 – 2011 duhet të përlllogariten interesat, pavarësisht moskonfirmimit nga Banka e Shqipërisë, por siç rezulton nga informacioni i përcjellë nga Union Bank, paratë janë investuar në depozitë dhe ashtu siç është e njohur për Komisionin Bonot e Thesarit kanë vlerë nominal edhe vlerë blerjeje, e cila është më e ulët se vlera nominale (ashtu siç quhet në zhargonin e përditshëm interesat nga bonot e thesarit përfitohen që në fillim). Në fakt Bono Thesari kam pasur edhe në vitet e tjera dhe interesat nga investimi në Bono Thesari janë tërhequr cash në momentin e investimit... Komisioni duhet të mbajë në konsideratë se për çdo afat maturimi në këto dy investime në Bono Thesari interesat për secilin investim kanë qenë afërsisht me një mesatare 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë përfitim, ku në çdo vit kjo shumë shkonte mesatarisht 100.000 (njëqind mijë) lekë”.

20.6 Në vijim, Komisioni mori në vlerësim pretendimet e subjektit të rivlerësimit që si burim i krijimit të depozitave bankare, që janë investuar në Bono Thesari në vitet 2010 – 2011, kanë shërbyer deklarimet e gjendjeve cash të kursyera në shtëpi, duke filluar nga viti 2007 deri në vitin 2009.

20.7 Në deklaratat periodike dhe shpjegimet në pyetësorin nr. 2²⁵, subjekti i rivlerësimit i referon shumat e deklaruar si shtesa në çdo vit. Shuma e gjendjes cash, deklaruar në Deklaratën Vetting është në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë. Më poshtë paraqitet tabela me shumat e gjendjes cash të deklaruar për çdo vit në deklaratat periodike vjetore, si dhe në Deklaratën Vetting.

Gjendje cash në banesë	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	D. Vetting
DPV shtesa / pakësime	500.000	600.000	900.000	400.000	- 1.300.000	700.000	300.000	700.000	700.000	700.000	400.000

²⁵ Me nr. *** prot., datë 8.9.2023.

Gjendje cash DPV, pyetësor	500.000	1.100.000	2.000.000	2.400.000	1.100.000	1.800.000	2.100.000	2.800.000	3.500.000	4.200.000	400.000
Gjendje cash prapësime	500.000	1.100.000	2.000.000	²⁶ 1.400.000	²⁷ 0	700.000	300.000	700.000	700.000	700.000	400.000

20.8 Në DPV-të vjetore nuk deklarohet se burim i krijimit të depozitave të investuara në Bono Thesari në vitet 2010 – 2011 të jenë kursimet *cash* të deklaruar në DPV-të e viteve 2007, 2008 dhe 2009. Po ashtu, edhe në Deklaratën *Vetting* si burim i krijimit të pasurisë Bono Thesari deklarohen kursimet nga paga dhe jo gjendja *cash*. Në seancë dëgjimore, përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit pretendoi se këto kursime *cash* nga pagat subjekti i mbante në shtëpi për t'i pasur disponibël për të paguar këstin e mbetur të likuidimit të apartamentit me sipërfaqe 99.9 m², por në fakt i ka investuar për krijimin e pasurisë Bono Thesari sipas 2 investimeve të viteve 2010 dhe 2011. Në seancë dëgjimore u pretendua se: “... *qoftë në deklarimet që kemi dhënë në ILDKPKI, qoftë në pyetësorët e dërguar nga Komisioni, kemi shpjeguar se gjendja cash nuk ka të bëjë me shumën totale, por ajo shumë e shënuar pasqyron gjendjen cash të kursyer duke llogaritur nivelin e të ardhurave me nivelin e shpenzimeve, ndërsa lidhur me faktin nëse kjo gjendje, nëse do të kishim një kursim në vitin 2011, një kursim në vitin 2012 e në vijim dhe në vitin pasardhës do të kishim një shumë totale, po t'i referohesh të dyja depozitave në Bonon e Thesarit ku njëra maturohet në muajin qershor dhe tjetra në fillim të vitit ka shtesa në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë... burimi i këtyre shtesave është kursimi i vitit të mëparshëm dhe po t'i mbledhësh deri në kohën e përlllogaritjes... shkon në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë depozitimi i këtyre. Që do të thotë nga ai total një pjesë është deklaruar në Deklaratën *Vetting* si gjendje, kurse pjesa tjetër nuk është ndonjë shumë e madhe për t'u konsumuar”.*

20.9 Komisioni konstatoi se për vitet 2007, 2008 dhe 2009 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në shumën totale 2.000.000 (dy milionë) lekë. Në vitin 2010 krijon Bono Thesari në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë të deklaruar në DPV-në e vitit 2010, pa cituar burimin e krijimit të saj. Gjatë vitit 2010, gjithashtu nuk deklaroi pakësimin e gjendjes *cash*. Gjatë vitit 2011 krijon Bono Thesari në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë, për të cilën deklaroi krijimin e saj gjatë këtij viti në DPV-në e vitit 2011, por nuk citon burimin e krijimit të saj. Po ashtu, në DPV-në e vitit 2011 deklaroi shtimin e vlerës së Bonos së Thesarit të krijuar në vitin 2010 me 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Në të njëjtin formular deklaroi pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar më parë me 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë. Që të mund të pakësojë gjendjen *cash* të kursyer në shtëpi me 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë do të thotë që përgjatë viteve të mund të ketë kursyer një vlerë më të lartë se së paku 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë, ndaj kështu marrin kuptim shpjegimet e saj se kursimet *cash* të deklaruar për çdo vit të përbëjnë shtesa të atij viti dhe jo gjendje totale *cash* të ruajtur në shtëpi. Megjithatë, në këtë logjikë do të duhej të kishte deklaruar edhe pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2010 për krijimin e Bonos së Thesarit prej 1.000.000 (një milion) lekësh në qershor të vitit 2010. Gjatë vitit 2011 është kryer edhe pagesa e këstit të mbetur të shtëpisë së banimit në vlerën 6.480 (gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë) euro, ndaj subjekti gjatë vitit 2011 ka përballuar 2 shpenzime të konsiderueshme: këstin e shtëpisë dhe krijimin e Bonos së Thesarit 1.000.000 (një milion) lekë, ku të ardhurat e deklaruar për këtë vit janë vetëm pagat dhe interesat bankarë në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë, të cilat nga informacioni i përcjellë nga Banka e Shqipërisë²⁸ rezultojnë në vlerë më të ulët.

20.10 Në lidhje me interesat e gjeneruara në momentin e investimit në Bono Thesari, Njësia Ligjore e Komisionit në analizën fillestare ka përlllogaritur interesat për vitet, në të cilët dispononte informacion nga Banka e Shqipërisë. Në prapësime dhe gjatë seancës dëgjimore u pretendua se kjo analizë ishte e copëzuar dhe pjesore, por nuk u paraqit dokumentacion bankar për të argumentuar mbi vlerën e saktë të përfituar nga interesat bankarë. Pas riçeljes së hetimit administrativ, Komisioni rikërkoi pranë bankave të nivelit të dytë dhe Bankës së Shqipërisë informacion mbi vlerat e interesave bankarë të përfituar nga investimet në bono thesari. Banka

²⁶ Pakësuar *cash*, duke investuar në Bono Thesari.

²⁷ Pakësuar *cash* duke investuar në Bono Thesari.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2023.

e Shqipërisë²⁹ ka përcjellë informacionin e plotë në lidhje me interesat e gjeneruara nga Bonot e Thesarit të viteve 2010 dhe 2011. Këto vlera janë përlogaritur nga Njësia Ligjore e Komisionit në analizën e përgjithshme financiare të subjektit, si dhe në mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për të krijuar pasurinë Bono Thesari dhe shtesat e saj përgjatë viteve deri në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë sa është deklaruar në Deklaratën *Vetting*.

20.11 Për sa i përket gjendjes së deklaruar *cash* pas vitit 2012 deri në vitin 2016 ka një rritje thuajse eksponenciale të gjendjes *cash* prej 3.100.000 (tre milionë e njëqind mijë) lekësh në total në fund të vitit 2016, gjendje që në Deklaratën *Vetting* për një periudhë të shkurtër kohore reduktohet në vetëm 400.000 (katërqind mijë) lekë. Nga hetimi dhe verifikimi i deklarimeve periodike pas Deklaratës *Vetting*, në vitin pasardhës 2017 nuk rezulton që subjekti të ketë krijuar një pasuri me këto kursime. I pyetur në seancë dëgjimore për shpenzimin e menjëhershëm të rreth 2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekësh nga fundi i vitit 2016 deri në janar të vitit 2017 kur është hartuar Deklarata *Vetting*, përfaqësuesi i subjektit të rivlerësimit pretendoi se shtesat e gjendjes *cash* janë shpenzuar për shtimin e vlerave të bonove të thesarit gjatë këtyre viteve, megjithatë ky pretendim nuk arrin të provohet në asnjë formë duke qenë se në deklarimet periodike vjetore 2012 – 2016 nuk ka deklarime të pakësimit të gjendjeve *cash*.

20.12 Nëse, sipas shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore do të konsideronim se në vitin 2013 si burim për shtesën në shumën 500.000 (pesëqind mijë) lekë në Bono Thesari ka shërbyer gjendja e likuiditetit *cash* në banesë, atëherë në këtë vit subjekti i rivlerësimit do të rezultonte në mundësi financiare për krijimin e likuiditeteve. Në këtë situatë, nga analiza financiare do të rezultonte në pamundësi financiare në vlerën -11.503 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tre) lekë në vitin 2011 për krijimin e gjendjes *cash* dhe pagesën e këstit të shtëpisë dhe në pamundësi financiare në shumën -218.307 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatë) lekë për periudhën 2012 – 2016, në total në shumën -229.810 (dyqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë.

20.13 Në vlerësim të trupit gjykues, shpjegimi më logjik në lidhje me gjendjen *cash* të subjektit të rivlerësimit pas vitit 2012 deri në vitin 2016 është që shuma e deklaruar *cash* përgjatë këtyre viteve të jetë gjendje e krijuar gjatë atij viti siç e kemi shpjeguar edhe në pikën 24.8 më poshtë. Edhe në këtë rast, pamundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për të krijuar pasurinë Bono Thesari do të ishte e njëjtë si më sipër në vlerën -229.810 (dyqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë.

20.14 Në konkluzion të së gjithës, për krijimin e pasurisë Bono Thesari në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me burim të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, të akumuluar në banesë nga kursimet nga pagat dhe interesat bankarë, subjekti i rivlerësimit rezulton në kushtet e pamjaftueshmërisë me burime financiare për të justifikuar krijimin e saj sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në vitin 2011 në vlerën -11.503 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tre) lekë dhe në vitet 2012 – 2016 në vlerën -218.307 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatë) lekë; në total -229.810 (dyqind e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë.

20.15 Kjo situatë në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të përdorura nga subjekti për këtë pasuri, si dhe pasaktësia në deklarimin e gjendjes *cash* (dukshëm e ardhur si pasojë e mosdijenisë mbi plotësimin e saj dhe pa asnjë dyshim për krijimin e situatave të qëllimshme për të justifikuar pasuri) do të konsiderohet në vlerësim tërësor të të gjithë kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

21. Llogari bankare në emër të K. L. në Credins Bank, në vlerën 2.108.63 (dy milionë e njëqind e tetë mijë e gjashtëdhjetë e tre) lekë me burim nga pagat e prindërve.

²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2023.

21.1 Në pyetësorin e datës 23.8.2023, subjekti i rivlerësimit sqaron se gabimisht në Deklaratën *Vetting* është shënuar emri i Credins Bank. Raiffeisen Bank konfirmon balancën e llogarisë në datën 27.1.2017.

21.2 *Pas verifikimeve, nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri.*

22. Tokë bujqësore me sipërfaqe 2800 m², e përfituar me ligjin nr. 7501/1991, në bashkëpronësi me familjen bujqësore të babait të subjektit P. M.. Nuk është deklaruar vlerë për pasurinë dhe subjekti është justifikuar me mosdeklarimin e saj më parë për arsye se nuk ka qenë në dijeni më parë.

22.1 Pranë Komisionit është administruar AMTP-ja³⁰ nr. ***, datë 24.4.1993, në emër të shtetasit P. M., ku rezulton që ai dhe gjithë familja bujqësore të kenë përfituar 19.894 m² sipërfaqe totale, nga e cila truell me sipërfaqe 300 m² dhe arë me sipërfaqe 19.594 m².

22.2 Drejtoria Vendore e ASHK-së Gramsh informon Komisionin se nuk është bërë ndarje apo pjesëtim pasurie për të marrë secili bashkëpronar pjesën e vet takuese. Subjekti ka deklaruar në Deklaratën *Vetting* se i përket 2800 m², që do të thotë 1/7 pjesë e pasurisë. Gjithsesi, nuk është paraqitur certifikatë familjare datë 1.8.1991 e familjes së shtetasit P. M., për të vërtetuar përbërjen familjare të familjes gjatë kësaj periudhe dhe për të kuptuar se cilat janë pjesët takuese të secilit prej tyre, duke prezumuar bashkëpronësinë në pjesë të barabarta të pandara.

22.3 Subjekti, duke qenë subjekt ligjzbatues dhe ekzekutuese e tij, nuk mund të justifikohet me padijeninë e ligjit për deklarimin e pronësisë së kësaj pasurie sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

22.4 *Subjektit iu kalua barra e provës për të shpjeguar në mënyrë shteruese arsyen e mosdeklarimit në vite të kësaj pasurie në pronësi të saj, si dhe sqarimin e pjesës takuese duke paraqitur një Certifikatë Familjare datë 1.8.1991 të familjes së babait P. M..*

22.5 Në vijim të kalimit të barrës së provës subjekti prapësoi se: “*Bashkëlidhur ju dërgoj Certifikatën Familjare datë 1.8.1991 të familjes së P. M.. Unë jam martuar në vitin 1993 dhe nuk kam qenë e lidhur me familjen bujqësore. Toka ka qenë e peregjistruar dhe në këto kushte nuk kam menduar se duhet ta deklaroja. Pavarësisht sa më sipër vlerësoj se është e qartë se kjo pasaktësi në DPV-të vjetore është e karakterit formal dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit, për shkak se nuk ka pasur asnjë qëllim për shmangien nga kontrolli i organeve verifikuese për shkak se kjo pasuri ka burim të plotësisht të ligjshëm”.*

22.6 Komisioni vlerëson se pretendimet e subjektit mund të pranohen. Kjo pasuri është përfituar në bazë të ligjit “Për tokën” dhe në bazë të numrit të anëtarëve të familjes përfituese. Në bazë të Certifikatës Familjare datë 1.8.1991 rezulton se familja M. përbëhej nga 8 anëtarë, ku secili ka përfituar 1/8 pjesë të pandarë të pronës. Për sa kohë burimi i krijimit të kësaj pasurie është në bazë të ligjit dhe nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kontributin dhe të ardhurat që subjekti ka përfituar nga ushtrimi i detyrës, pasaktësia e mosdeklarimit në vite të kësaj pasurie nuk përbën shkak për t’u vlerësuar në dëm të subjektit.

23. Në lidhje me vendbanimin e subjektit të rivlerësimit. Në deklaratimet periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar adresën e Gjendjes Civile ku është regjistruar: *Njësia Administrative *** Nr. ***, pall. ***, ap. ***, shk. ***.* Kjo adresë është e njëjtë me adresën: rr. “***”, *Njësia Administrative Nr. ***, ***, Tiranë”.*

23.1 Apartamenti i ndodhur në këtë adresë (në katin e tretë të pallatit 5-katësh, nr. ***, me sipërfaqe 64.5 m²) i përket vjehrrës së subjektit të rivlerësimit, znj. B. L., dhe rezulton të jetë blerë nga kunati M. L. kundrejt vleftës 1.000.000 (një milion) lekë.

³⁰ Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 9.9.2021 të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Gramsh.

23.2 Subjekti i rivlerësimit banon në Elbasan pjesën më të madhe të kohës meqenëse e ushtron detyrën aty. Banesat ku ajo ka jetuar rezultojnë të jenë:

- a) “Lagjja “****”, pallati nr. ***, hyrja nr. ***, ap. ***, Elbasan, në pronësi të znj. A. Ç..
- b) Lagjja “****”, pallati i ***, Elbasan, në pronësi të shtetasve A. P. e S. P..

23.3 Komisioni verifikoi konfliktin e interesit me shtetasit me të cilët ka qenë në marrëdhënie qiraje, prej nga rezultuan të dhëna³¹ për verifikime të mëtejshme.

23.4 Për sa i përket shpenzimeve për qiranë, subjekti ka deklaruar gjatë hetimit³² shpenzimet për qiranë, të cilat janë konsideruar si shpenzime në analizën financiare.

23.5 Në vitin 2016 është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit adresë banimi edhe në Tiranë, rruga “****”, Zona e ***, ***.

23.6 *Pas verifikimeve, nuk u konstatuan problematika.*

24. ANALIZA FINANCIARE E PËRGJITHSHME PËR PERIUDHËN 2003 – 2016

24.1 Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioni në këtë analizë financiare është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, Deklaratën *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në:

24.2 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikua dhe u krahasua përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, në Deklaratën *Vetting*, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

24.3 Nga analiza e përgjithshme financiare rezultojnë se për periudhën 2003 – 2016 subjekti i rivlerësimit është me vlerë negative prej -1.683.809 (një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntë) lekësh, përkatësisht: - 1.453.999 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë në vitet 2005 – 2007 për krijimin e likuiditeteve bankare dhe gjendjes *cash* në vitin 2007; në vlerën -11.503 (njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tre) lekë në vitin 2011 për pagimin e këstit të fundit të pasurisë shtëpi banimi me sip. 99.9 m², por edhe të shtimit të pasurisë Bono Thesari, si dhe në vlerën -218.307 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatë) në vitin 2012 për shtimin e pasurisë Bono Thesari.

³¹ Referuar shkresës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, protokolluar me nr. *** prot., datë 11.9.2023.

³² Përgjigje e pyetjes 1 të pyetësorit standard administruar në datën 1.3.2021.

Subjekti i rivlerësimit

ZENA LILA

Prokurore, Prokuria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan

																			Rezultati negativ	(1,683,809)
	2002	1993-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016					
Përshkrimi	2002	1993-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016					
PASURI	79,712	1,201,636	1,900,671	2,398,720	624,098	1,291,944	836,819	781,404	287,348	1,126,683	1,536,179	-55,582	957,805	-406,014	-107,141					
Shtepi banimi 2+1, Rr. ***, Tiranë, kontr. Dt. 22.12.2011							6,775,038			896,184										
Automjet Ford Fusion, Kontrate dt. 10.10.2014														420,330						
Objekt sip. Totale 247 m2, ndertesa 92.71 m2 ne *** Gramsh, kontr. Dt. 10.07.2002	79,712	79,712																		
Toke bujqesore me ligjin 7501, viti 1991 2800 m2, bashkepronesi me familjen e babait te SR																				
SHTESA/PAKESIME LIKUIDITETE		1,121,924	1,900,671	2,398,720	624,098	1,291,944	(5,938,218)	781,404	287,348	230,499	1,536,179	(55,582)	537,475	(406,014)	(107,141)					
TOTAL LIKUIDITETE		1,121,924	3,022,595	5,421,315	6,045,413	7,337,357	1,399,138	2,180,543	2,467,891	2,698,389	4,234,569	4,178,986	4,716,461	4,310,447	4,203,306					
DETYRIME	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0					
							0													
PASURI NETO (1-2)		1,201,636	1,900,671	2,398,720	624,098	1,291,944	836,819	781,404	287,348	1,126,683	1,536,179	-55,582	957,805	-406,014	-107,141					
TË ARDHURA	1,132,963	4,785,464	2,793,048	1,859,366	1,325,457	1,482,008	1,466,171	1,502,875	1,507,720	1,721,660	1,936,064	1,795,461	2,009,734	2,020,993	1,808,585					
Te ardhura nga paga subjekti	139,685	1,938,649	827,844	823,398	805,758	803,767	790,919	861,641	874,779	854,183	971,939	935,412	1,119,713	1,195,228	1,079,123					
Te ardhura nga bursa Shkolla Magjistrautes vitet 2000-2002	208,260	531,320																		
Te ardhura nga paga bashkeshorti	316,928	1,847,405	474,576	318,228	331,476	393,365	477,149	641,234	559,612	704,347	779,188	684,144	792,202	714,064	691,896					
Dhurate nga i vellai per M. L. 3.500 USD	468,090	468,090																		
Te ardhura nga shitja Objekt sip. Totale 247 m2, ndertesa 92.71 m2 ne *** Gramsh, kontr. Dt. 01.02.2005				500,000																
Te ardhura nga shitja magazines,garazhd			1,100,000																	
Te ardhura nga transferte AK Invest K. L. 15.09.2015															6,500					
Te ardhura nga interesat bankare			51,094	217,740	188,223	284,876	198,103		73,329	163,130	184,937	175,905	97,819	105,201	37,566					
Mundesi per kursim			1,439,534																	
SHPENZIME	375,576	2,144,294	390,856	498,228	498,228	606,480	606,480	606,480	606,480	606,480	618,192	1,017,907	969,792	1,020,345	1,063,550					
Shpenzime jete se	375,576	2,144,294	375,856	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368					
Shpenzime qiraje			15,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000	60,000					
Shpenzime shkollimi femijet, djali v.2013-2019, vajza v. 2015-2018													29,800	29,800	59,800					
Shpenzime mobilimi apartamenti Tirane												357,000								
Shpenzime udhetimi						100,147			6,941		7,011	7,006		3,441	3,382					
DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4-3-5)	757,387	1,439,534	501,521	-1,037,583	203,132	-416,416	22,871	114,991	613,892	-11,503	-218,307	833,136	82,137	1,406,661	852,176					

25. Vlerësim i përgjithshëm në lidhje me kriterin e pasurisë Subjekti i rivlerësimit Zena Lila ka pasur një karrierë të gjatë në detyrë dhe një historik deklarimi të interesave privatë që në vitin 2003. Në raport me Komisionin ka pasur një sjellje bashkëpunuese, duke iu përgjigjur pyetjeve të tij dhe ka qenë disponibël sipas mënyrave dhe rrugëve të komunikimit që ka deklaruar në Komision. Nuk ka qenë pjesëmarrëse në seancë për shkak të problemeve shëndetësore, duke zgjedhur për tu përfaqësuar nga një përfaqësues ligjor.

25.1 Në deklaratimet fillestare periodike janë vënë re pasaktësi në deklarime, të cilat lidheshin me momentet kohore të krijimit të pasurive apo likuiditeteve bankare, deklarimi për të cilat duhet të përfshinte krijimin e tyre brenda një viti kalendarik të plotë, pavarësisht momentit të deklaratimit. Këto pasaktësi, të cilat ndikonin në gjendjen e likuiditeteve vjetore dhe në rezultatet e analizës financiare, i ka shpjeguar në prapësime, për të cilat Komisioni nëpërmjet Njësisë Ligjore i ka rishikuar më pas vlerat e likuiditeteve dhe pasurive të krijuara nga ky subjekt, duke pranuar shpjegimet mbi pasaktësitë në deklarime pasi ato ishin logjike e përputheshin me gjendjen e dokumentuar të akteve në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, e që nuk janë bërë as për të fshehur gjendjen reale të pasurive, as burimet e krijimit të tyre.

25.2 Pas realizimit të një hetimi të thelluar administrativ, duke konsideruar edhe pretendimet e subjektit dhe kërkesat e veçanta për marrjen e provave shtesë, mbeti i paprovuar pretendimi për përfitimin e një shume në total prej 1.600.000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh nga shitja e shtëpisë në Gramsh, nga të cilat vlera prej 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekësh u pretendua të ishte përfituar nga shitja e sipërfaqeve të paregjistruara, truall, magazina, garazh etj. Për rrjedhojë, ky pretendim u vlerësua si deklarativ, duke qenë se nuk u provua në asnjë formë e, për më tepër, subjekti e solli në vëmendje vetëm për efekt të procesit të rivlerësimit.

25.3 Akumulimi i gjendjes *cash* nga subjekti i rivlerësimit në shtëpi deri në vitin 2011 është i kuptueshëm, për shkak se pritej që në këto vite familja e subjektit të shlyente këstin e dytë të blerjes së shtëpisë apartament me sipërfaqe 99.9 m². Bindës është edhe fakti që pakësimi i gjendjes *cash* në vlerën 1.300.000 (një milion e treqind mijë) lekë të deklaruar në vitin 2011 nuk ka se si të kuptohet ndryshe, pa u konsideruar si shtesë dhe akumulim i gjendjeve *cash*, të deklaruara në DPV-të vjetore nga viti 2007 deri në fund të vitit 2009. Këto shtesa të akumuluar janë krijuar nga kursimet nga pagat dhe interesat bankarë si të vetmet mundësi të ardhurash të subjektit të rivlerësimit gjatë viteve 2007 – 2009, por edhe gjatë viteve 2010 – 2016, kur ka krijuar dhe shtesa në Bono Thesari. Nëse vlerësojmë në një interpretim logjik gjendjen e kursimeve të deklaruara nga subjekti rivlerësimit ndër vite dhe gjendjen faktike të pasurive të krijuara rezulton se në mënyrë kronologjike kursimet janë mbajtur në bankë (nëpërmjet derdhjeve vjetore) deri në blerjen e pasurisë së vetme të zotëruar nga dy bashkëshortët. Më tej kursimet në të njëjtën logjikë janë depozituar në bono thesari duke akumuluar në vitin 2016 një vlerë prej 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh (me burim kursime nga të ardhurat e tyre).

25.4 Nga ana tjetër, deklaratimet e gjendjes *cash* të subjektit gjatë viteve 2012 – 2016 si shtesa nuk krijojnë vijueshmëri logjike dhe nuk gjejnë harmoni me situatën e pasqyruar në Deklaratën *Vetting*. Kjo pasi deri në fund të vitit 2016 krijohet një gjendje e akumuluar *cash* në vlerën 3.100.000 (tre milionë e njëqind mijë) lekë, e cila për më pak se një muaj në momentin e hartimit të Deklaratës *Vetting* reduktohet në 400.000 (katërqind mijë) lekë pa krijuar pasuri të paktën në vlerën 2.700.000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë si diferencë e këtyre shumave me njëra-tjetrën. Mundësia e konsiderimit të tyre si burim për krijimin e shtesave të Bonove të Thesarit pas vitit 2012 nuk arrin të provohet si e tillë, me përjashtim të shtesës në vitin 2013, në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Megjithatë, edhe kjo mbetet e paprovuar tërësisht referuar deklarimeve periodike vjetore dhe burimeve të deklaruara në deklaratimet periodike vjetore për shtimin e likuiditeteve në Bono Thesari.

25.5 Trupi gjykues çmon se situata faktike e gjendjes *cash* gjatë viteve 2010 – 2016 dukshëm nuk është deklaruar saktë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore, përderisa

nuk krijon vijueshmëri logjike dhe as harmoni me deklarinimin e gjendjes *cash* në Deklaratën *Vetting*. Po ashtu, nuk rezultojnë pasuri të tjera të krijuara apo shpenzime të mundshme të kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit të cilat mund të krijojnë dyshime të arsyeshme se deklarimet e pasakta mund të ishin të qëllimshme. Rezultati negativ financiar mbi gjendjen e pamjaftueshmërisë financiare të subjektit të krijuar për vitet 2010 – 2016, është i ulët në krahasim me vlerën 3.100.000 (tre milionë e njëqind mijë) lekë të krijuar nga akumulimi i gjendjes *cash*, ndaj në vlerësim të trupit gjykues kjo gjendje mund të mos reflektojë situatën faktike të subjektit. Leximi më koherent dhe logjik i gjendjes *cash* të deklaruar për vitet 2010 – 2016 është që gjendja *cash* të jetë gjendje e krijuar gjatë vitit të deklarimit deri në Deklaratën *Vetting*.

25.6 Në analizë të përgjithshme, pasuria e subjektit të rivlerësimit përgjatë periudhës së rivlerësimit përbëhet nga një shtëpi e ndodhur në Selitë, një automjet tip “Ford Fusion” dhe një pasuri Bono Thesari në vlerën 3.860.000 (tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, e krijuar me kursimet e punës së pandërprerë prej vitit 1992 për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin e saj. Rezultati negativ financiar gjatë vitit 2005 për shkak të pretendimit, por mosprovimit të shumës 1.100.000 (një milion e njëqind mijë) lekë si e përfituar nga shitja e shtesave të shtëpisë në Gramsh, rezultati negativ në vitin 2007 dhe rezultati negativ gjatë viteve 2010 – 2016, që dukshëm ka ardhur për shkak të pasaktësive në deklarime e bëra ndër vite të kursimeve *cash*, në frymë të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak të qëllimshëm të penalizimit me masën disiplinore të shkarkimit sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

25.7 Në tërësi vlerësohet se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

26. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, ajo ka dërguar në datën 30.10.2017 raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Zena P. Lila.

Komisioni ka kryer verifikime, si dhe i ka kërkuar AKSIK-së të bëjë përditësim dhe deklasifikim të raportit për subjektin e rivlerësimit Zena Lila, përderisa raporti pararendës kishte kryer verifikime deri në datën 30.10.2017.

27. Me shkresat e datave 21.9.2023 dhe 20.10.2023 u përcoll informacioni i përditësuar, prej ku nuk kanë rezultuar të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit apo informacione prej të cilave mund të ngrihen dyshime për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar.

28. AKSIK-ja ka dërguar në datën 31.10.2023 raportin për subjektin e rivlerësimit Zena Lila të deklasifikuar plotësisht, duke konstatuar përshtatshmëri për vijimin e detyrës.

29. Nga hetimet/verifikimet, Komisionit nuk i kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme për këtë subjekt.

30. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Zena Lila ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

31. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale është hartuar mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional,

lidhur me 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe 3 dosjeve të dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, si dhe të dhëna e *indicie* nga denoncimet lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit.

32. Nga vlerësimi i 8 dosjeve të paraqitura për vlerësimin profesional të subjektit nuk kanë rezultuar gjetje. Rezulton se për dosjet e analizuar veprimet hetimore të kryera kanë qenë të plota, si dhe në dinamikë e në respektim të afateve ligjore, kualifikimi i veprës penale ka qenë korrekt dhe konstatohet se subjekti i rivlerësimit e ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë. Prokurorja shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Nga vëzhgimi i kryer rezulton që përfundimet e arritura bazohen në lidhjen logjike mes fakteve të parashtruara në akt dhe aplikimit të normës penale të zbatueshme në rastet konkrete.

33. Në analizë të dosjeve të vëzhguara konstatohet se subjekti Zena Lila ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuar dhe numrin total të çështjeve të përfunduara për të gjithë periudhën e vlerësimit. Gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa, në të cilat të jetë provuar që nga ana e subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

TË DHËNAT ARKIVORE LIDHUR ME ANKESA, MASA DISIPLINORE DHE VLERËSIME

34. Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit Zena Lila rezultoi se nuk është marrë asnjë masë disiplinore, nuk ka pasur të dhëna për përfshirje në veprimtari të dyshimta, si dhe nuk ka pasur materiale hetimore, mosfillime apo procedime penale në ngarkim të saj.

35. Po ashtu, edhe Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar konfirmon që në regjistrat e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, nuk rezulton që në emër të shtetasës Zena Lila të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

36. Pranë drejtorisë ekonomike dhe të burimeve njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë ka të dhëna për vlerësimin e punës së kësaj prokuroreje, të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, prej ku rezulton që gjatë viteve 2012 – 2016 të ketë vetëm një vlerësim “mirë” dhe të tjerat “shumë mirë” .

DENONCIME

37. Denoncim i shtetasit F. T.³³

37.1 Faktet në lidhje me këtë denoncim lidhen me akuzat për zvarritje hetimesh nga ana e prokurores Zena Lila. Denoncuesi ankohet se konflikti për pronësinë që ka me shtetasit E. P. dhe S. P. i ka çuar në konfrontim fizik, ku shtetasi E. P. e ka dhunuar dhe, si pasojë, ka vështirësi me shikimin. Akti i ekspertimit e ka klasifikuar këtë dëmtim në kategorinë e atyre dëmtimeve të përhershme dhe të rrezikshme për jetën.

37.2 Denoncuesi përmend që aktualisht ka një procedim të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për këtë çështje për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”. Megjithatë, prokurorja e çështjes Zena Lila, sipas denoncuesit, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e çështjes, agresorja vazhdon në gjendje të lirë, duke provokuar dhe acaruar më tepër marrëdhëniet mes dy palëve.

³³ Ankesë nr. *** prot., datë 12.2.2021.

37.3 Në vijim, Komisioni kërkoi të njihet me dosjen e plotë të procedimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

37.4 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan³⁴ përcolli dosjen e procedimit nr. ***, viti 2020, për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”, sipas nenit 88 të Kodit Penal.

37.5 Sipas akteve, rezulton që ngjarja t’i jetë referuar Prokurorisë në datën 22.10.2020 nga Komisariati i Policisë, ndërsa procedimi penal është regjistruar në datën 29.10.2020 nga prokurorja Zena Lila për veprën penale “Plagosje e lehtë me dashje në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal. Regjistrimi i procedimit penal është bërë brenda afatit të përcaktuar nga Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar.

Pas rezultateve të aktit të ekspertimit në datën 18.11.2020, eksperti mjekoligjor konkludoi se viktimi kishte pësuar ënjtje dhe hematoma të rënda të syrit, të cilat hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve që shkaktojnë humbje të aftësisë së përhershme në punë. Me këtë rezultat duhet të ndryshonte edhe kualifikimi i veprës penale, nga neni 89 në nenin 88 të Kodit Penal për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”.

Rezultoni të mos jetë ndërmarrë asnjë veprim hetimor apo procedural nga momenti i daljes së aktit të ekspertimit, deri në datën 8.1.2021, kur prokurorja ka dhënë pëlqimin për heqjen dorë nga hetimi i procedimit penal. Kërkesa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes ka ardhur për faktin se prokurorja Zena Lila ka ndjekur një procedim të mëparshëm me të njëjtat palë, ku është vendosur pushimi i çështjes dhe kërkuesit kishin arsye të dyshonin se kishte shkaqe të rëndësishme perceptimi njëanshmërie.

Prokurori zëvendësues që ka ndjekur më pas hetimet ka vijuar me regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale dhe ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale sipas nenit 88 të Kodit Penal, “Plagosje e rëndë me dashje”.

37.6 Moskryerja e veprimeve hetimore pas rezultateve të aktit të ekspertimit mbetet e pashpjegueshme dhe duket se kemi të bëjmë me zvarritje të hetimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit.

37.7 *Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konkluzionit të mësipërm.*

37.8 Pas kalimit të barrës së provës, në vijim të sqarimeve të kërkuara nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Procedimi penal nr. ***, viti 2020, është regjistruar mbi bazën e materialeve hetimore të referuara nga policia gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Peqin. Procedimi penal është regjistruar në dyshimin për konsumimin e elementeve të veprës penale “Plagosje e lehtë me dashje”, që parashikohet nga neni 89 i Kodit Penal... Referuar përmbajtjes se urdhrit për kryerjen e veprimeve hetimore, veprimet hetimore i janë deleguar për t’u kryer oficerit të policisë gjyqësore, N. N.. Oficerit të policisë gjyqësore i është përcaktuar si afat për kryerjen e veprimeve hetimore data 15.12.2020. Pra, oficerit të policisë gjyqësore i është lënë afat 1 muaj e 15 ditë për kryerjen e veprimeve hetimore. Deri në datën 15.12.2020 dosjen penale e ka pasur oficeri i policisë gjyqësore dhe konkluzionet e akteve të ekspertimit janë administruar prej tij. Në fund të muajit dhjetor bëhet planifikimi për mbartjen e dosjeve penale për vitin pasardhës. Me qëllim zvogëlimin e ngarkesës së punës për vitin pasardhës, përfundohen të gjitha dosjet hetimore me autor dhe që veprimet hetimore janë të plota. Po kështu, në fund të vitit dhe fillimvitit të ri, disa ditë janë pushime për shkak të festave të fundvitit. Nga data 15.12.2020 deri në datën 8.1.2021, kohë kur unë kam dhënë heqjen dorë nga hetimi, kanë kaluar vetëm pak ditë. Referuar ngarkesës së madhe në punë dhe faktit që kishim të bënim me një procedim penal pa emër personi të regjistruar, në regjistrin e njoftimit të veprave penale kalimi i këtyre ditëve nuk përbën zvarritje të hetimit. Heqjen dorë nga procedimi e kam bërë, për faktin se ankuesi F. T. kërkonte zëvendësimin tim me një prokuror tjetër. Bazuar në parimin që drejtësia jo vetëm të bëhet, por edhe duhet të duket se po bëhet,*

³⁴ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 11.9.2023.

duke qenë se F. T. kishte humbur besimin tek prokurori i ngarkuar me hetimin, unë Zena Lila kam dhënë pëlqimin për t'u zëvendësuar në këtë procedim penal”.

37.9 Për sa u përket shpjegimeve të paraqitura në vijim të barrës së provës, trupi gjykyes arsyeton se proceduralisht është prokurori ai që drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e policisë gjyqësore dhe interesi për ecurinë e hetimit duhet të jetë i vazhdueshëm, pavarësisht afatit të caktuar për raportim oficerit të policisë gjyqësore. Në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit “Urdhër për kryerjen e veprimeve hetimore”, datë 29.10.2020, ngarkuar oficerit të policisë gjyqësore N. N., konstatohet se ky i fundit ka qenë i detyruar të raportojë çdo dy javë tek prokurorja Zena Lila për ecurinë e hetimit dhe lënien e detyrave në vijimësi. Duke marrë të mirëqenë zbatimin e këtij urdhri, përjashtohet mundësia që subjekti i rivlerësimit të mos kishte dijeni për aktin e ekspertimit mjekoligjor të datës 18.11.2020, sipas konkluzioneve të të cilit duhet të kishte ndryshuar kualifikimi ligjor i veprës penale të konsumuar.

Është e kuptueshme ngarkesa në punë e institucioneve të dhënies së drejtësisë, megjithatë për një drejtësi efektive dhe përforcimin e besimit të publikut tek institucionet e dhënies së drejtësisë, nevojitet që subjektet e rivlerësimit të ndjekin rastet, të jenë të vëmendshëm dhe të reagojnë apo të marrin menjëherë masat e nevojshme, në këtë rast në drejtim të formulimit të akuzës dhe kualifikimit të duhur të veprës penale.

38. Denoncim nëpërmjet burimeve të hapura në lidhje me grabitjen e një shtëpie në Cërrik³⁵. Ngjarja ka ndodhur në Cërrik, në prill të vitit 2019 dhe është denoncuar në media në tetor të vitit 2019, ku tre të rinj të maskuar kanë grabitur familjen Sh. dhe kanë keqtrajtuar anëtarët e familjes. Denoncuesja shprehet se nga kamerat e sigurisë janë identifikuar qartë agresorët, të cilët viktimat i kanë njohur, pasi i kishin komshinj dhe kushërinj. Sipas të dhënave të paraqitura nga denoncimi, procedimi penal është regjistruar në datën 24.4.2019, por agresorët rezultojnë se janë larguar nga Shqipëria. Denoncuesi akuzon prokuroren e çështjes Zena Lila për zvarritje hetimesh dhe mosmarrje të asnjë mase ndalimi sa i përket kufizimit të lëvizjes së agresorëve, sepse në atë mënyrë nuk do të kishin mundësi të largoheshin jashtë shtetit.

38.1 Komisioni kërkoi të njihet me dosjen e plotë të procedimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Prokuroria³⁶ është përgjigjur se nuk ka asnjë kallëzim penal të paraqitur nga denoncuesja F. Sh. dhe as ndonjë procedim penal në ngarkim të personave të akuzuar, të cilët përmenden në programin televiziv, të trajtuar nga subjekti i rivlerësimit.

38.2 Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar që nuk ka trajtuar asnjë kallëzim penal me kallëzues shtetasen F. Sh. apo ndonjë anëtar tjetër të familjes Sh. në Cërrik, që ka qenë pre e sulmit dhe vjedhjes nga ana e agresorëve.

38.3 Pas kalimit të barrës së provës, në vijim të sqarimeve të kërkuara nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Referuar periudhës së gjatë në detyrën e prokurorit në Prokurorinë Elbasan, unë kam hetuar mjaft vjedhje në qytetin e Cërrikut. Shtetasen F. Sh. apo familjarë të saj nuk njoh. Nuk kujtoj që të kem hetuar mbi vjedhjen e banesës së kësaj shtetaseje. Për të dhënë një përgjigje të bazuar në dokumentacion provues, i jam drejtuar Prokurorisë Elbasan për të më njohur me procedimin penal të regjistruar në bazë të kallëzimit penal të bërë nga shtetasja F. Sh., me qëllim për të mësuar mbi faktin nëse kam qenë apo jo unë prokurorja që kam hetuar mbi faktin. Me shkresën me nr. *** prot., datë 14.11.2023 (shkresë të cilën po e dërgoj bashkëlidhur përgjigjes), Prokuroria e Rrethit Elbasan më konfirmon se nuk rezultojnë ndonjë material referues/kallëzues nga shtetasja F. Sh.. Sa më lart, unë prokurore Zena Lila nuk kam trajtuar asnjë kallëzim penal me kallëzuese F. Sh. apo ndonjë anëtar tjetër të familjes Sh. në Cërrik, që kanë qenë pre e sulmit dhe vjedhjes nga ana e agresorëve, pasi nga kjo shtetase nuk ka kallëzim penal apo material të referuar në Prokurori”.*

³⁵<https://stop.tvklan.al/stop-emisioni-27-sezoni-5-8-tetor-2019-cerrik-grabisin-shtepine-e-identifikohen-nga-viktimat-prokuroria-ben-sehir/>; <https://stop.tvklan.al/stop-grabija-ne-cerrik-ceshtja-ne-hetim-por-dhunesit-kane-lene-shqipperine-20-janar-2020/>

³⁶ Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 4.10.2023 dhe shkresës nr. *** prot., datë 11.9.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

38.4 Komisioni vlerëson se për këtë denoncim të shfaqur nëpërmjet burimeve të hapura, si prokuroria, ashtu edhe vetë subjekti në shpjegimet e dhëna prej saj, konfirmuan që nuk kishte procedime apo kallëzime me familjen Sh., që të ishte trajtuar nga subjekti i rivlerësimit Zena Lila. Për këtë u siguruan tri shkresa nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit. Komisioni gjykon që në rastin konkret çështja rezultoi të mos jetë shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit dhe si *indicie* do të gjykohet në tërësi në raport me elementet e tjera të vlerësimit profesional të subjektit.

GJETJE TË TJERA

39. Nga të dhënat e sistemit TIMS dhe deklaratimet e vetë subjektit të rivlerësimit³⁷ ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. M. L., ka pasur njohje dhe marrëdhënie miqësore me shtetasin G. Gj., duke udhëtuar me të dhe ndenjtur tek shtëpia e mikut të tij në Kosovë.

39.1 Gjatë hetimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka drejtuar procedimin penal nr. ***, viti 2011, me kallëzues shtetasin G. Gj., për veprën penale “Përdorimi me keqdashje i thirrjeve telefonike”, të parashikuar nga neni 275 i Kodit Penal.

39.2 Komisioni konstaton se në kuadër të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, duket se subjekti ka pasur konflikt interesi për të ndjekur këtë procedim dhe duhet të kishte dhënë dorëheqjen.

39.3 *Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të shpjeguar arsyet pse nuk ishte tërhequr nga ky procedim penal, nga i cili dukej të kishte pasur konflikt interesi për ta ndjekur.*

39.4 Pas kalimit të barrës së provës, në vijim të sqarimeve të kërkuara nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: *“Në lidhje me këtë procedim penal, unë Zena Lila nuk kam qenë në konflikt interesi. G. Gj. ka qenë kallëzuesi, viktimi e veprës penale. Kallëzimin penal dhe deklaratimet e tij G. Gj. i ka dhënë përpara oficerit të policisë gjyqësore, në Komisariatit e Policisë. Në kohën kur është regjistruar procedimi penal, unë Zena Lila nuk kam qenë në dijeni që bashkëshorti im M. L. njihej me shtetasin G. Gj.. Mbi faktin e njohjes ndërmjet tyre unë kam mësuar disa vite pas vitit 2011, ku kam mësuar se shoqëria ndërmjet tyre lidhej me faktin që të dy merreshin me gjueti. Për sa kohë nuk isha në dijeni të kësaj njohjeje të G. Gj. me bashkëshortin tim, nuk kisha pengesë për hetimin mbi faktin e kallëzuar penalisht. Kjo çështje është zgjidhur me marrëveshje, kallëzuesi ka hequr dorë nga kallëzimi penal. Duke qenë se kjo çështje penale nuk mund të vazhdonte proceduralisht, për shkak të tërheqjes së ankimit nga viktimi e veprës penale, unë me cilësinë e prokurores kam marrë vendim për pushimin e çështjes. Pra, nuk kam dhënë asnjë lloj zgjidhjeje, por kam miratuar heqjen dorë nga ankimi i kallëzuesit të veprës penale”.*

39.5 Komisioni gjykon se pretendimet e subjektit janë bindëse. Kallëzuesi është tërhequr vetë nga procedimi dhe nuk ka pasur ndonjë vendimmarrje favorizuese nga ana e subjektit të rivlerësimit apo sjellje, që në dukje të përbënte moszbatim të duhur të ligjit apo etikës nga ana e subjektit të rivlerësimit për këtë çështje.

VLERËSIM I KRITERIT TË AFTËSIVE PROFESIONALE

40. Nga analiza në tërësi e kriterit të aftësive profesionale të subjektit rezultoi se subjekti ka arritur një nivel të kënaqshëm sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Duke konsideruar faktin që znj. Zena Lila ka një karrierë të gjatë në sistem dhe ndaj saj në Komision ka pasur vetëm një denoncim shkresor, në vlerësim tërësor për Komisionin kjo përbën tregues të një pune të bërë në përgjithësi me përgjegjshmëri, pa konfliktime apo pakënaqësi prej viktimave apo denoncuesve.

³⁷ Referojuni përgjigjes së pyetjes 12 të pyetësorit standard, administruar në datën 1.3.2021.

41. Nga të dhënat arkivore nuk rezultoi të jenë dhënë masa disiplinore, të ketë pasur kallëzime apo procedime penale ndaj saj, si dhe nuk rezultoi të ketë pasur të dhëna për përfshirje në veprimtari të dyshimta. Nga analizimi i 8 dosjeve të shqyrtuara të procedimeve të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit Zena Lila rezultoi se veprimet hetimore kanë qenë të plota, dinamike dhe në përputhje me afatet procedurale. Subjekti i rivlerësimit është vlerësuar për aftësitë e saj organizative, gjuhën jodiskriminuese dhe të paanshme të përdorur në aktet e përpiluara dhe për njohuritë adekuate në aplikimin e legjislacionit të zbatueshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, duke çmuar se subjekti:

- ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- ka arritur një nivel të kënaqshëm kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

në bazë të nenit 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Zena Lila, me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 10.1.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Firdes SHULI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Elda Faruku